



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • ëëë.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1902

Prishtinë, Dt. 05.06.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji/Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit
Projektpropozimi	“Caktimi i statusit ekologjik të lumit Morava e Binçës në sezonën e verës duke përdorur makroinvertebrorët bentik si indikatorë të cilësisë së ujit”. “Determination of ecological status of the Morava of Binça river in summer season using benthic invertebrates as indicators of water quality”
Kandidati	Muhamet Morina
Mentori	Prof.Dr. Ferdije Zhushi Etemi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 21.07.2023 Vendimi nr.: 3556
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Dorëshkrimi i temës së diplomës master i kandidatit Muhamet Morina është shkruar në 44 faqe, me stil Times new roman, me madhësi 12. Ai përmbanë 22 tabela, dhe 30 figura, ndërsa janë cituar 18 burime të literaturës.</p> <p>Dorëshkrimi përmbanë Abstraktin në gjuhën shqipe dhe angleze, Hyrjen, Qëllimin e hulumtimit, Materiali dhe Metodat, Rezultatet, Diskutimin, Përfundimet/Konkluzat, Literaturën dhe Biografinë e shkurtë të kandidatit.</p> <p>Në kapitullin Hyrja autori ka parashtruar problematiken e hulumtimit dhe ka treguar rëndësinë e ujit për jetën e njeriut dhe qenjeve tjera.</p> <p>Gjithashtu ai ka treguar shqetësimet që po shfaqen si rezultat i ndotjes së ujërave siërfaqësore nga veprimtaritë e shumta stresuese antropogjene. Në këtë kapitull autori ka përshkruar edhe historikun e</p>

shfrytëzimit të makroinvertebrorëve bentik për vlerësimin e cilësisë së ujërave si dhe përparësitë që kanë këta organizma në hulumtime, në krahasim me organizmat tjerë. Për shkak të rolit të tyre si bioindikatore të ekosistemeve ujore, Direktiva Kornizë e ujërave të Europës i ka përfshirë makroinvertebrorët bentikë si elemente biologjike të domosdoshme për vlerësimin e cilësisë së ujërave. Në kapitullin vijues autori paraqet qellimin e hulumtimit si dhe parashtron Hipotezën e cila pritet që të arsyetohet nga rezultatet e hulumtimit të tij.

Te kapitulli Materiali dhe metoda, kandidati së fillim përshkruan karakteristika gjeografike të regjionit të cilit i takon lumi Morava e Binçës, si dhe përshkruan rrjedhën e tij e më pastaj përshkruan edhe secilin nga 6 lokalitetet e mostrimit të makroinvertebrorëve. Në vazhdim autori përshkruan metodën e përdorur për mbledhjen e makroinvertebrorëve në lokalitetet e hulumtuara, mënyrën e klasifikimit të materialit në laborator si dhe determinimin e tij me stereomikroskop binokular me ndihmën e çelësave adekuat gjer në familje dhe konzervimin e mostrave në alkohol.

Ka kapitulli Rezultatet përfshinë rezultatet në formë tabelare dhe grafike të përbërjes së makroinvertebrorëve bentik në secilin lokalitet të hulumtuar të lumit Morava e Binçës, pastaj vlerat e indeksave biotik të llogaritur EPT, FBI, BMËP, ASPT dhe SËRC si dhe klasifikimin e cilësisë së ujit në kategori në bazë të vlerave të fituara të këtyre indeksave për secilin lokalitet.

Autori cekë se gjatë hulumtimit të tij janë mbledhur gjithësej 503 individë nga substrate të ndryshme, të cilët në aspektin taksonomik iu takojnë 12 rendeve dhe 30 familjeve. Grupi më dominant ka qenë ai i insekteve me një llojllojshmëri të familjeve prezente në mostra, Kjo shifër paraqet një faunë relativisht të pasur të rrjedhës së lumit Morava e Binçës pasi që sasia e ujit ka qenë mjaft e mirë për shkak të reshjeve të shumta në pranverë. Sidoqoftë, vlerat mesatare të indeksave biotikë e kategorizojnë vetëm lokalitetin Korbuliq në cilësi të mirë, lokalitetin Marec me cilësi mesatare, kurse 4 lokalitetet tjera të lumit kategorizohen si të cilësisë së dobët, gjë që duhet të jetë shqetësim për gjendjen ekologjike të lumit në përgjithësi. Gjendja e monitoruar dëshmon për një ndotje të theksuar të lumit. Burimet kryesore që i përkeqësojnë kushtet ekologjike dhe natyrore të lumit Morava e Binçës janë: shkarkimi i ujërave të zeza nga vendbanimet në afërsi, aktivitetet bujqësore si dhe mbetjet e ndryshme organike dhe inorganike të depozituara direkt në lumë.

Në kapitullin Diskutimi autori analizon rezultatet e fituara gjatë hulumtimit të tij dhe i krahason ato me rezultatet e ngjashme të autorëve tjerë në lumin Morava e Binçës. Në fund autori paraqet Konkluzat që kanë dalur nga ky hulumtim dhe listën e burimeve të shfrytëzuara të Literaturës.

Përfundimi dhe propozimi

Duke patur parasysh rëndësinë shkencore të temës së realizuar si dhe mënyrën e dizajnit dhe realizimit të saj, konsiderojmë se kjo temë është origjinale dhe jep kontribut në njohjen e


gjendjes reale ekologjike të lumit Morava e Binçës.

Bazuar në ato që u tha më lartë, i propozojmë Këshillit Shkencor Mësimor të Departamentit të Biologjisë dhe FSHMN-së të aprovojë Raportin për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatit Muhamet Morina, me titull “Caktimi i statusit ekologjik të lumit Morava e Binçës në sezonën e verës duke përdorur makroinvertebrorët bentik si indikatorë të cilësisë së ujit” dhe kandidatit ti mundësojë mbrojtjen publike të saj.


Prishtinë, 04.06.2024

Komisioni:

1. Prof. Dr. Halil Ibrahim, kryetar



2. Prof. Dr. Ferdije Zhushi Etemi, anëtare/mentore



3. Prof. Dr. Linda Grapci Kotorri, anëtare

